



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 Ligji për Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall :

KONKURS

Titulli i punës: Kostumograf /e

Institucioni: Teatri Kombëtar i Kosovës

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës- IX

Paga: Page fikse

Numri i referencës: 31/2018

I përgjigjet: Drejtorit të Teatrit Kombëtar të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Bën përgatitjen dhe të mbaruarit e skicës kostumografike;
2. Kryen në mënyrë studiuëse përgatitjen për punë kostumografike për shfaqje, mbledhë dhe studion dokumentacionin në bazë të veprës;
3. Punon skicat e kostumeve, 7 maskave, këpucëve, cilindrave, aplikacioneve, stolive, armëve etj.;
4. Dorëzon skicën e plotë kostumografike për të marr leje nga komisioni pas konsultimit me regjisorin dhe skenografinë;

5. Prezanton në të gjitha provat në punëtorinë e rrobaqepësisë në skenën e teatrit;
6. Bën patinimin e kostumeve.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Diplomë e Fakultetit të Arteve, drejtimi -dizajn i skenografisë dhe kostumografisë;
2. Të ketë të realizuara kostumografit, në 5 shfaqje, të paktën 3, në Teatrin Kombëtar të Kosovës (duhet dëshmohet me referenca nga regjisorët dhe kontrata);
3. Të ketë shkathtësi komunikimi dhe aftësi të punës në presion;
4. Njohja e gjuhës Angleze është përparësi .

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e lartë adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, Ligjin për Teatrot, Nr. 04/L-106 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore.

Kohëzgjatja e emërimit: Kandidati që pranohet, përmes Konkursit publik, merr kontratë 6 mujore për periudhën provuese , me mundësi të vazhdimit sipas suksesit dhe angazhimit të treguar.

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

Kandidatët duhen ti dorëzojnë dokumentet e kompletuara si vijon:

- Diplomë e fakultetit të arteve, drejtimi- Dizajn i skenografisë dhe kostumografisë ;
- Dëshmitë me referenca nga regjisorët dhe kontrata, për 5 shfaqje të realizuara, të paktën 3, të realizuara në Teatrin Kombëtar të Kosovës;
- Dokumenti i identifikimit.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 11.07.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>)